



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 25.05.2023

Nr: 145

Ora: 16:10

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 75, DATË 22.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 25.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia "Aleanca Demokristiane e Shqipërisë" përfaqësuar nga z. Zef Bushati

OBJEKT: 1. Kundërshtimin e vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e bashkisë në zonën zgjedhore bashkia Kamëz, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023".



2. Rinumërim dhe rivlerësim i votave të vlefshme dhe të pavlefshme të subjekteve në kutitë e votimit për Këshillin Bashkiak.

3. Ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultatit për Këshillin Bashkiak.

BAZË LIGJORE:

Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 75 regj., datë 22.05.2023. Në seancën e datës 24.05.2023 KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta, duke qartësuar palës ankimuese se duhet të saktësojë objektin e saj, të paraqesë provat bashkëlidhur, si dhe një përshkrim më të detajuar të fakteve dhe rrethanave konkrete.

Me anë të vendimit nr. 137, datë 24.05.2023, KAS vendosi kthimin e kërkesës ankimore për plotësim të elementeve të formës, me një afat 24 orë, si dhe zhvillimin e seancës paraprake më datë 25.05.2023, ora 16:00.

Në mbledhjen e datës 25.05.2023, ora 16:10, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua dhe u pohua nga administrata e KQZ-së se subjekti ankues nuk e kishtë ridepozituar kërkesën ankimore të korrigjuar.

Për këto arsye, duke qenë se kërkesa nuk është riparaqitur e korrigjuar dhe as ankimuesi nuk u paraqit në seancë, megjithë njoftimin e tij rregullisht, në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 75, datë 22.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të tij.

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar